

Dallimi mes *el-Makdij uel-Makdur* dhe *el-Kada uel-Kader* në dashjen dhe urrejtjen e asaj që ndodh nga *el-Kader*

Shejh Ibn Uthejmin [rahimehullah]

"...për sa i përket *el-makdij* [ajo që është paracaktuar], kjo është tre llojesh:

Lloji i parë: Ajo me të cilën jemi të detyruar të jemi të kënaqur

Lloji i dytë: Ajo me të cilën është e ndaluar të jemi të kënaqur

Lloji i tretë: Ajo me të cilën është e rekomanduar të jemi të kënaqur

Për shembull, mëkatet janë nga *makdijjaat* [çështjet e paracaktuara] të Allahut dhe s'është e lejueshme që të jemi të kënaqur me mëkatet, edhe nëse ato ndodhin me kadanë e Allahut. Kështu që kushdo që shikon mëkatet nga këndvështrimi i el-kadasë, e cila është vepra e Allahut, atëherë është e detyrueshme që ai të jetë i kënaqur dhe të thotë, "Vërtet, Allahu është i Urtë, dhe po të mos ishte paracaktuar nga urtësia e Tij, kjo s'do të ndodhte." Për sa i përket asaj që paracaktohet [el-makdij], e cila është mosbindje ndaj Allahut, atëherë është e detyrueshme që të mos jemi të kënaqur me të, ndërsa është e detyrueshme të përpiqemi t'i japim fund asaj, qoftë kjo nga vetvetja apo nga të tjerët [nëse këtë e bëjnë të tjerët].

Ekziston një lloj nga ajo që është paracaktuar me të cilën jemi të detyruar të jemi të kënaqur, siç është detyrimi ligjvënës, nga që Allahu e ka gjykuar atë si *kuenen* [shprehur në aftësinë krijuese të Tij] dhe e ka gjykuar atë si *sher'en* [legjislativisht], andaj me këtë jemi të detyruar të jemi të kënaqur nga pikëpamja e el-kadasë [e cila është vepër e Allahut] dhe el-makdij [e cila është ajo çka është paracaktuar të ndodhë përbrenda krijimit].

Lloji i tretë, me të cilën është e rekomandueshme të kënaqemi dhe në të cilën duhet pasur durim, është çfarëdo qoftë që ndodh nga *mesa'ib* [fatkeqësitë]. Kështu që çfarëdo që ndodh nga *mesa'ib*, është e rekomandueshme [*mustehab*] që të jemi të kënaqur me të sipas opinionit të shumicës së dijetarëve, por kjo s'është e detyrueshme. Sidoqoftë, të qenit i duruar në këtë është e detyrueshme..." [Mexhmu Fetava të shejh Ibn Uthejmin 2/62].

Shejh Abdur-Rahman bin Nasir es-Se'di [rahimehullah]

"... Për sa i përket veprimit të robit, i cili përbëhet nga veprat e bindjes dhe mosbindjes, atëherë është e detyrueshme të jemi të kënaqur me veprat e bindjes që ndodhin nga ai dhe të tjerët veç tij dhe t'i duam ato, dhe t'i urrejmë veprat e mosbindjes që ndodhin nga ai dhe tjerët veç tij. Pra,

kënaqësia dhe urrejtja në këto dy lloje i kthehen veprës së robit, dhe kjo [sipas radhës] i kthehet pajtimit të Zotit, ose dashurisë së Tij për veprat e bindjes, ose urrejtjes së tij për veprat e mosbindjes, si dhe ndarjes që Ai bën mes këtyre dyjave në vendimet e kësaj bote dhe jetës së përtejme. Pra, neve na takon që të pajtohemi me Allahun lidhur me këtë. Për sa i përket këndvështrimit të tekndirit të Allahut për ta [veprave të bindjes dhe mosbindjes] dhe veprës së Zotit [dmth el-kada uel-kader] nga e cila ato buruan, atëherë është e detyrueshme për ne që të jemi të kënaqur me to nga ky këndvështrim, duke qenë në pajtim me Zotin tonë në këtë, ngase Ai paracaktoi të mirën dhe të keqen dhe e deshi të mirën dhe e urreu të keqen që ndodhi nga robërit. Kështu që me këtë detal ndërpritet vështirësia në këtë çështje të rëndësishme, e cila kërkon një kriter praktik. Dhe kushdo që nuk bën dallim në këtë mënyrë, ai do të bjerë në lloje të ndryshme të gabimeve dhe paditurisë." [el-La'i ued-Durer es-Se'dije, f.544]

Shejh Ibn el-Kajjim [rahimehullah]

"Për sa i përket çështjes së të qenit i kënaqur me el-kadanë, atëherë thuhet:

Së pari: Më anë të cilit Libër apo me anë të cilit Sunet, apo me cilin kuptim jeni informuar lidhur me detyrimin e të qenit i kënaqur me çdo gjë që Ai paracakton? Madje edhe me vetëm lejueshmërinë e kësaj, e lere më detyrimin në të?

Ky është Libri i Allahut, Suneti i të dërguarit [salallahu alejhi ue selam] dhe dëshmitë e intelektit, dhe në to s'ka gjë për urdhërimin e as për lejueshmërinë e saj.

Pra, nga *el-makdij* [çështjet e paracaktuara] është ajo me çka Ai është i kënaqur, dhe nga ajo që e hidhëron Atë dhe e bën Atë që të urrejë. Ndaj, ne s'jemi të kënaqur me çdo *kada*, mu ashtu siç Ai që i paracakton vendimet e Tij s'është i kënaqur me të. Më saktë, nga *el-kada* është ajo që e hidhëron Atë, mu ashtu siç nga qeniet e paracaktuara janë ato mbi të cilat bie hidhërimi dhe urrejtja, dhe të cilat mallkohen e qortohen.

Dhe së dyti thuhet: Ekzistojnë dy çështje: "*kada*," dhe kjo është vepër [*fi'l*] e vendosur me Vetën e Zotit, më të lartit; dhe "*makdij*," dhe kjo është vepra e kryer [*mef'ul*], e ndarë nga Ai. Pra, *el-kada*, e tëra është mirësi, drejtësi dhe urtësi, prandaj duhet të jemi të kënaqur me tërë atë. Dhe, *el-mekdij* është dy llojesh. Nga ajo është përgjigja e atij që thotë se *fi'l* [vepra] është e ndryshme nga *el-mef'ul* [ajo që kryhet, bëhet] dhe se *el-kada* është e ndryshme nga *el-makdij*. Përsa i përket atij që thotë se *el-fi'l* është e njëjta gjë sikurse *el-mef'ul*, dhe *el-kada* është e njëjta gjë sikurse *el-makdij*, atëherë s'është e mundur për të që të përgjigjet me këtë përgjigje.

Së treti thuhet: *el-kada* ka dy aspekte, e para: raporti i saj me Zotin, më të lartin, dhe atribuimi i saj Atij. Pra, nga ky këndvështrim, më tërë këtë duhet të jemi të kënaqur. Këndvështrimi i dytë: raporti i saj më robin dhe atribuimi i saj atij. Nga ky këndvështrim, kjo ndahet në atë me të cilën duhet të jemi të kënaqur dhe në atë me të cilën s'duhet të jemi të kënaqur.

Shembull: Marrja e jetës së ndokujt i ka dy vlerësime. Nga këndvështrimi se Allahu e ka paracaktuar, e ka shkruar dhe e ka dashur atë, dhe ka bërë që ajo të ndodhë në një afat të caktuar për atë që vritet, si dhe përfundimin e jetës së tij, njeriu duhet të jetë i kënaqur me këtë. Nga këndvështrimi se kjo ka ndodhur nga vrasësi dhe se ai është angazhuar në të [vrasjen], e ka merituar atë dhe ka vazhduar në këtë me vullnetin e tij, dhe e ka kundërshtuar Allahun me këtë vepër, atëherë njeriu duhet të hidhërohet me këtë dhe kjo s'duhet ta kënaqë atë." [el-Medarixh 1/268-169]

Shejh ul-Islam Ibn Tejmije ka thënë, me rastin e sqarimit të dyshimeve të atyre që kanë devijuar në çështjen e *el-kaderit*:

"Për sa i përket çështjes së tretë, atëherë kjo është thënia e tij: "Në lidhje me atë që është transmetuar për sa i përket të qenit i kënaqur me kadanë e Allahut, nga transmetimet dhe ajetet, nëse ato janë mëkate që ndodhin nga tjetër pos kadasë së Allahut, atëherë kjo është e pamundur dhe është ofendim i Teuhidit, e nëse ato ndodhin nga kadaja e Allahut, atëherë urrejtja dhe mospëlqimi i tyre është urrejtje dhe mospëlqim i kadasë së Allahut, më të lartit."

Pastaj thuhet: Nuk ka në Librin e Allahut e as në Sunetin e të dërguari të Allahut ndonjë ajet apo hadith që urdhëron robërit që të jenë të kënaqur me çdo çështje të caktuar [*makdij mukader*] nga veprat e robit, të mirat dhe të këqijat nga ato. Ky është parim fundamental, të cilit duhet t'i japim rëndësi. Mirëpo, është e detyrueshme për njerëzit që të jenë të kënaqur me çfarëdo që ka urdhëruar Allahu, dhe s'bën që ndokush të hidhërohet me atë që ka urdhëruar Allahu. Më i Larti ka thënë:

"Por jo, pasha Zotin tënd, ata s'do të jenë besimtarë gjersa të bëjnë ty [O Muhamed] gjyqtar në konfliktet mes tyre dhe të mos kenë kurrfarë kundërshtimi kundër vendimeve tua e t'i pranojnë ato me nënshtrim të plotë." Nisa:65

Më i Larti ka thënë:

"Kjo ngase ata ndoqën atë me çka hidhërohej Allahu, ndërsa urrenin atë me çka Ai kënaqej. Kështu ai ua bëri të padobishme veprat." Muhamed:28

Dhe Ai tha:

"Sikur të ishin kënaqur me atë që ua dha Allahu dhe i dërguari i Tij dhe të thonin:"Na mjafton Allahu. Allahu do të na furnizojë nga begatitë e Tij dhe po ashtu i dërguari i Tij [nga lëmosha, etj]. Ne e lusim Allahun [që të na pasurojë]." et-Teubeh:59

Përmendja e të dërguarit në këtë ajet shpjegon se dhënia [e përmendur në ajet] është dhënie fetare, ligjvënëse [*el-ita ed-dini esh-sheri'j*], jo dhënie e paracaktuar e krijimit [*el-ita el-kauni el-kaderij*]. Dhe ai [salallahu alejhi ue selam] ka thënë në hadithin sahi:"E ka shijuar ëmbëlsinë e

Imanit ai që ka marrë Allahun për Zot, Islamin për fe dhe Muhamedin për pejgamber." [Muslim në Kitabul-Iman].

Është e dëshirueshme që njeriu të kënaqet me çfarëdo që Allahu ka paracaktuar për të nga fatkeqësitë [*mesa'ib*] që s'janë mëkate, siç është të sprovuarit e tij me varfëri, me sëmundje, me nënçmim, apo me dëmtim nga krijesat. Sepse, durimi në rastin e fatkeqësive është i detyrueshëm, dhe për sa i përket të qenit i kënaqur me to, kjo është ligjëruar. Mirëpo, a është kjo e detyrueshme apo e rekomandueshme? Nga dy thëniet e shoqëruesve të Ahmedit dhe të tjerëve, më i sakti prej tyre është se kjo është e rekomandueshme [*mustehab*], jo e detyrueshme [*uaxhib*].

Është e ditur që vend-mbajtja më e fortë e Imanit është dashja për hir të Allahut dhe urrejtja për hir të Allahut. Dhe, Allahu na ka urdhëruar që të urdhërojmë për të mirë, ta duam atë dhe të jemi të kënaqur me të, si dhe t'i duam njerëzit e kësaj; dhe që ta ndalojmë të keqen, ta urrejmë atë dhe të hidhërohemi me të, si dhe t'i urrejmë njerëzit e kësaj dhe të përpiqemi kundra tyre me duart, gjuhët dhe zemrat tona.

Pra, si mund të merret me mend se s'ka asgjë ne krijimin